



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Komisioni për Buxhet dhe Financa**

**Legjislatura e III-të**  
**Nr. 12/08**  
**Prishtinë, më 5.06.2008, ora 13:00**  
**Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301**

**PROCESVERBAL**

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

**Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Besa Gaxherri, Safete Hadërgjonaj, Armend Zemaj, Xhevdet Neziraj, Müfera Şinik, Hajdin Abazi.**

**Anëtarët jo të pranishëm: Haki Shatri, Kosara Nikolić, Myrvete Pantina, Shkumbin Demaliaj, Behxhet Pacolli.**

Nga shërbimi i sekretarisë: Natasha Tisma-Prica, Arta Hajra, Vilson Ukaj, Dashurie Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: z.Hasan Isufaj zv.Drejtor i Buxhetit pranë Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, Alisa Birdaini GP 7+, Drenusha Mula – praktikante, monitruar nga OSCE, KDI, NDI.

**Kryesues: Gani Koci, kryetar i Komisionit.**

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit të Radio Televizionit të Kosovës (RTK) për vitin 2007**  
**Të ftuar: Përfaqësuesit e bordit të RTK-së;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. L-016/1 për Ushqimin me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. L-055 për Sigurinë Private me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, me amendamente;**

6. **Shqyrtimi i Kërkesës nr. 03/0641/ Do-346, dt. 26.05.2008 së MEF-it për ri-destinimin e mjeteve financiare të projektit kapital „Kompleksi i Ri Qeveritar” në projektin kapital „Renovimi i Pallatit të Mediave”;**

**I ftuar:**

**Ministri për Ekonomi dhe Financave.**

7. **Të ndryshme**

- 7.1. **Fillimi i procedurës së shqyrtimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.**

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe propozoi rendin e ditës. Kryetari pasi konstatoi se ftesës për mbledhje nuk i'u janë përgjigjur përfaqësuesit e bordit të RTK-së kërkoi që kjo pikë të shtyhet për shqyrtim në mbledhjen e radhës. Propozoi të bëhet rirenditja e pikave të rendit të ditës. Pas pikës së dytë të shqyrtohet pika e gjashtë, pastaj pika pestë dhe në fund pika shtatë e rendit të ditës. Ndërsa pika e katërt për shkak të mungesës së kohës sepse pas një ore fillon seanca plenare së bashku me pikën e dytë të shtyhen për shqyrtim mbledhjen e ardhshme.

**Safete Hadërgjonaj** u pajtua me propozimin e kryetarit dhe kërkoi që për shkak të mungesës së përfaqësuesve të bordit RTK-së, kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për shqyrtim në mbledhjen e ardhshme.

**Besa Gaxherri** duke pasur parasysh faktin se mbledhja është caktuar pa qenë në dijeni, që pas një ore do të jetë seanca plenare e radhës, kërkoi që disa pika të shtyhen për shqyrtim në mbledhjen e radhës, sidomos pika tretë për shkak të mungesës së përfaqësuesve të RTK-së.

Rendi i ditës u miratua me propozimet e parafolësve.

## **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

**Safete Hadërgjonaj** theksoi se ka bërë vërejtjet me shkrim për procesverbalet nga mbledhjet e 8 dhe 14 maj 2008 lidhur me diskutimin e saj dhe ato nuk janë përmisuar. Kërkoi që të njëjtat përmisime të bëhen dhe vërejtjet të shkruhen në procesverbalin pasues dhe si të përmisuar të publikohen në Web faqen e Kuvendit dhe të jenë në dispozicion për të gjithë anëtarët e komisionit.

Procesverbali nga mbledhja e kaluar dt. 26.05.2008, u miratua pa vërejtje.

3. **Shqyrtimi i Kërkesës nr. 03/0641/ Do-346, dt. 26.05.2008 së MEF-it për ri-destinimin e mjeteve financiare të projektit kapital „Kompleksi i Ri Qeveritar” në projektin kapital „Renovimi i Pallatit të Mediave”;**

**I ftuar: Ministri për Ekonomi dhe Financave**

**Kryetari** kërkoi nga përfaqësuesi i MEF të jep sqarimi rreth kërkesës për ri-destinimin e mjeteve financiare nga një projekt kapital në një tjetër.

**Hasan Isufaj zv.Drejtor i Buxhetit pranë Ministrisë për Ekonomi dhe Financa** theksoi si Departament i Buxhetit kemi shqyrtuar kërkesën dhe duke u mbështetur në Ligjin Mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Ligjin e Buxhetit kemi konstatuar se shumica e ri-destinimit kalon mbi 40% të mjeteve të projekteve kapitale dhe për këtë transfer duhet vendos paraprakisht Kuvendi dhe PSSP-ja. Duke u bazuar në këtë kemi përcjellur kërkesën në Kuvend dhe kërkojmë që ajo të përkrahët sepse shtyerja e miratimit të saj, paraqet pengesë në realizimin e këtij projekti të rëndësishëm kapital.

**Kryetari** lidhur me kërkesën theksoi se iniciativa e Qeverisë për kalimin e institucioneve publike nga objektet private në ato publike, përveç arsyeve politike dhe strategjike ka edhe bazueshmërinë ligjore. Kjo kërkesë bazohet edhe në Ligjin Mbi Menaxhimin e Financave Publike me të cilin lejohet bartja e mjeteve prej një linje buxhetore në të tjetrën. Kërkoj nga anëtarët që ta përkrahin atë.

**Armend Zemaj** përkrahu kërkesën si të tillë, por kërkoj të jepem disa sqarime. Duke pasur parasysh faktin, se Qeveria ka marrë obligim që të gjitha institucionet publike që veprojnë në objekte private, brenda vitit 2008 të vendosen në objekte publike, ndërsa kërkesa parasheh se renovimi i objektit “Pallatit të Mediave” do të përfundoj në vitin 2009, kërkoj shpjegime se deri në këtë kohë si do të bëhet zgjidhja e këtij problemi. Më tutje vazhdoi, projekti për renovimin e Pallatit të Mediave është përfunduar në vitin 2004, ndërsa me këtë kërkesës kërkohej 250.000 € kërkoj sqarime se a është paraparë kjo shumë prapë për projektin. Po ashtu z. Zemaj me interes të veçantë kërkoj të dijë se objekti që do të rinovohet, a i plotëson kushtet që të vendosen të gjitha institucionet publike. Në kërkesës thuhet tri apo katërt Ministri, të saktësohet se a do të vendosen tri apo katër Ministri. Duke pasur parasysh realizimin projektit të ri në Hajavali që do të bëhet, për vendosjen e të gjitha institucioneve publike, kërkoj që të bëhen zgjidhje të mira që të mos shpenzohen për të dy destinacionet.

**Besa Gaxherri** pyeti përfaqësuesin e Ministrisë, nga cila vijë buxhetore, Qeveria ka menduar se duhet bartur mjetet për këtë projekt. Deri sa nuk marrë sqarime të argumentuara, znj. Besa theksoi se voton kundër kësaj kërkesë.

**Safete Hadërgjonaj** theksoi se përkrah kërkesën si të tillë dhe është mirë që tani kërkesat e tilla për projektet kapitale po vijnë paraprakisht që të shqyrtohen në këtë komision e mëpastaj edhe në Kuvend, gjë që në mandatet e kaluar ka pasur problem, sidomos gjatë lëvizjeve të projekteve kapitale prej një linje buxhetore në tjetrën linjë buxhetore. Megjithatë, znj. Hadërgjonaj theksoi se është shqetësues fakti i zgjatjes së procedurës së shqyrtimit të kësaj kërkesë, si rezultat i së cilës ka pamundësuar realizimin e shpenzimeve kapitale për projekte kapitale, siq është edhe ky projekt i paraparë më këtë kërkesës. Është një problem që po përcillet vazhdimisht dhe kërkoj sqarime për një vonesë të tillë procedurale.

**Hasan Isufaj zv.Drejtor i Buxhetit pranë Ministrisë për Ekonomi dhe Financa** lidhur me vonesën e procedimit të kërkesës, theksoi se njëra ndër arsyet e zgjatjes së saj është se Drejtori Buxhetit pranë MEF-it, me shkresë i'u ka drejtuar Kuvendit më 10 Prill, më pas ka ardhur vërejtja prej Kuvendit, se Drejtori i Buxhetit nuk mundet t'i drejtohet për këto çështje Kuvendit dhe një gjë të tillë duhet bërë Ministri. Pas kësaj vërejtje së pranuar, në emër të Ministri të MEF-it kërkesa është riproceduar me 21.04.2008 dhe prej asaj kohe nuk kemi informata rreth procedimit saj. Lidhur me pyetjet e z. Zemaj, z. Isufaj theksoi se arsyeshmërinë e transferim të mjeteve për renovim të projektit e ka bërë Qeveria në vendimet e saja dhe realizimi i një projekti të tillë është nevojë e domosdoshme sepse do të mundësonte kursimin e mjeteve të mëdha që paguhen për qira në objekte private. Ndërsa lidhur me atë se a mund të vendosen të gjitha institucionet publike në këtë objekt theksoi se nuk munden, por jozyrtarisht ka informata se do të rinovohen edhe objektet tjera publike dhe do të bëhet zgjidhja për të gjithë shërbyesit civil.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, Komisioni me votimin e bërë me gjashtë votë PËR dhe një KUNDËR (znj. Gaxherri) nxori këtë :

## R E K O M A N D I M

- I. Miratohet kërkesa për ridestinimin e projektit kapital „ Kompleksi i ri i objekteve të Qeverisë” nën kodin buxhetor 10012 , në shumën prej 8,411,478 € në projektin kapital “Renovimi i Pallatit të Mediave” në shumën prej 7,494,479 €

II. Për zbatimin e planit strategjik për objektin rezidencial të Qeverisë së Republikës së Kosovës, obligohet Ministria e Shërbimeve Publike.

III. Komisioni rekomandon që, Kryesia e Kuvendit, me rastin e përgatitjes së rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Kuvendit, ta rendis edhe shqyrtimin e rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, për ridestinimin e projektit kapital „Kompleksi i ri i objekteve të Qeverisë” në projektin kapital „Renovim i Pallatit të Mediave”.

#### **4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. L-055 për Sigurinë Private me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, me amendamente**

**Kryetari** njoftoi se Projektligji dhe amendamentet e Komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe kërkoi nga anëtarët ta përkrahin atë.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Komisioni me votimin e bërë njëzëri nxori këtë:

### **R E K O M A N D I M**

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa shqyrtoi Projektligjin nr. L-055 për Sigurinë Private dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- III. Bazuar në të lartshënuarat, Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

#### **5. Të ndryshme**

##### **5.1. Fillimi i procedurës së shqyrtimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat**

**Kryetari** kërkoi nga anëtarët, që Komisioni të marrë iniciativën për analizimin dhe shqyrtimin Ligjit nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe të bëjë propozimet konkrete për amendamentimin e tij, para se të filloj procedura e rregullt për ndryshimin dhe plotësimin e tij në Kuvend. Në këtë drejtim, për bashkëpunim theksoi se ka marrë përkrahjen edhe të përfaqësuesit të USAID-it në Kuvend, z. Haxhi Gashit.

**Safete Hadërgjonaj** lidhur me këtë propozoi që të krijohet një grup punues, të caktohet raportuesi si udhëheqës i grupit. Grupi punues pas takimeve që do të ketë, së bashku edhe me përfaqësuesin e USAID-it, të propozoj amendamentet, të cilat do të shqyrtohen dhe miratohen në Komision.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, me votimin të bërë Komisioni njëzëri nxori këtë:

### **V E N D I M**

Komisioni krijoi një grup punues që do të bëjë analizimin dhe shqyrtimin e Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe do të propozoj amendamentet të cilat do të shqyrtohen dhe miratohen nga Komisioni para se të bëhet leximi i parë i Projektligjit të propozuar nga Qeveria për e plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit ekzistues.

Anëtarët e grupit punues:

1. Gani Koci
2. Armend Zemaj (raportues)
3. Safete Hadërgjonaj
4. Hajdin Abazi
5. Shkumbin Demaliaj.

**Kryetari** në pikë të ndryshme njoftoi anëtarët se, përfaqësuesi i NDI për mbështetje të Komisionit për Buxhet dhe Financa, ashtu siç jemi akorduar, ka përgatitur raportin me informacione lidhur me monitorimin e Ligjit për Auditimin e Brendshëm. Nga raporti shifet se egzistojnë shumë vështirësi në zbatimin e këtij Ligji, si mosfunksionimin i duhur i Njësisë Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm, kjo tregon se si qëndron puna në institucionet tjera lidhur me auditimin e të tyre brendshëm, të cilën gjë e ka treguar edhe raporti i Revizorit Gjeneral. Duke parë një situatë të tillë dhe nevojën e mbikëqyerjes së këtij Ligji, propozoi që të formohet një grup punues që do të bëjë monitorimin e këtij Ligji në terren dhe më pas të përgatis raportin i cili do të diskutohet dhe miratohet në Komision.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, me votimin të bërë Komisioni njëzëri nxori këtë:

## V E N D I M

Komisioni krijoi një grup punues i cili do të bëjë monitorimin e Ligjit për Auditimin e Brendshëm dhe pas marrjes së informacioneve në teren do të përgatit raportin, i cili do të diskutohet dhe miratohet në Komision.

Anëtarët e grupit punues:

1. Gani Koci
2. Armend Zemaj (raportues)
3. Besa Gaxherri.
4. Safete Hadërgjonaj
5. Xhevdet Neziraj

Mbledhja e radhës u caktua më: 9.06.2008, (E Hënë) në orën 13:00.

Mbledhja përfundoi në ora 14:05

Shërbimi i komisioneve

**Kryetari i Komisionit**

---

**Gani KOCI**